

Republika e Kosovës – Republic of Kosovo

Raporti Gjashtëmujor



KOMUNA E MITROVICËS - REPUBLIKA E KOSOVËS	
MITROVICA - MITROVICA	
Nr. i dokumentit	02 01-052/01-0041018/16
Data/Orari	15.03.2026
Shënim	Mitrovicë - Mitrovica

Drejtoria e Mirëqenies Sociale - Komuna e Mitrovicës së Jugut

Periudha: Janar – Qershor 2026

Përgatitur nga: **Ramadan Beshiri**, Drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale



Fjala e Drejtorit

"Puna është gjuha më e mirë."

Mitrovica nuk është vetëm një qytet me sfida. Është një qytet me potencial, me njerëz të fortë dhe me një histori që na obligon të ndërtojmë të ardhmen.

Gjatë këtyre gjashtë muajve kemi bërë atë që është baza e çdo ndryshimi serioz: kemi dalë në terren, kemi dëgjuar qytetarët, kemi analizuar gjendjen reale sociale, kemi identifikuar problemet dhe kemi ndërtuar një pasqyrë të qartë mbi të cilën do të ndërtojmë politikat tona sociale.

Sot nuk flasim më nga hamendësimet. Flasin mbi të dhëna, mbi raporte dhe mbi një gjendje sociale të dokumentuar të komunës sonë. E njohim problemin dhe jemi duke ndërtuar zgjidhjet.

Në këtë periudhë kemi takuar dhe kemi dëgjuar çdo kategori. Askush nuk është lënë jashtë agjendës sonë sociale. Familjet në nevojë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, viktimat e dhunës, kategoritë e dala nga lufta dhe çdo qytetar që ka kërkuar mbështetje kanë qenë pjesë e punës sonë.

Ne nuk jemi vetëm administrues të shërbimeve sociale. Ne jemi përgjegjësi publike dhe dorë e zgjatur e qytetarit në momentin më të vështirë të tij.

Vizioni ynë është i qartë: Mitrovicë me një arkitekturë të plotë sociale. Për të pasur më shumë shërbime, duhet të kemi më shumë infrastrukturë sociale.

Objektet e reja, kapacitetet e reja dhe planifikimet e reja nuk janë vetëm ndërtime, janë investim në dinjitetin e qytetarëve.

Rënia graduale e numrit të përfrituesve të asistencës sociale është një tregues pozitiv, por nuk është qëllimi final. Asistenca sociale mbetet një mbështetje jetike për mijëra qytetarë tanë, por objektivi ynë është më i madh: të krijojmë mundësi që qytetarët të kalojnë nga përfritues të ndihmës në qytetarë aktivë, të aftësuar dhe të pavarur ekonomikisht.

Puna është gjuha më e mirë. Dhe ne do të vazhdojmë të flasim përmes punës.

Drejtoria e Mirëqenies Sociale


Drejtoria për Mirëqenie Sociale, Qendra për punë Sociale, Sektori për Çështje Sociale dhe Strehim dhe Sektori për Dëshmorët,

Invalid të Luftës, Veteran dhe Viktimat Civile konform dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës të cilat përcaktojnë

përgjegjësitë në sferën e mirëqenies sociale dhe në vizionin dhe misionin e saj për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare

për të gjithë qytetarët në nevojë sociale në Komunën e Mitrovicës, pasqyron punën për periudhën Janar-Qershor 2026.

Shifra të Progresit, Buxhetit dhe Përfaqësimit Publik



Rënie e 112 Familjeve Përfutuese nga asistenca sociale

Numri i familjeve përfutuese ka rënë nga **1,532** (dhjetor 2025) në **1,420** (qershor 2026) ulje prej **112 familjesh (7.31%)**.



Kuzhina Popullore

Projekti "Zarfi i Mërgjimitarit" ka nisur themelimin e Kuzhinës Popullore, me kapacitet për **150 qytetarë në ditë**.



Rezidenca e të Moshuarve

Parcela komunale në pritje për t'u ndarë për ndërtimin e Shtëpisë për të Moshuar, projekt me vlerë **630,000 €**, në bashkëpunim me MPFVÇ.



Shtëpia për Mbrojtjen e Fëmijëve

Parcela komunale në pritje për t'u ndarë për ndërtimin e Shtëpisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, projekt me vlerë **280,000 €**, në bashkëpunim me MPFVÇ.




Trajtimi i Drejtpërdrejtë i Qytetarëve

Drejtori ka trajtuar drejtpërdrejtë **mbi 500 palë** gjatë periudhës raportuese, duke ofruar zgjidhje sociale dhe administrative.



Përfaqësim Institucional në Media

Intervistë në **RTK** për raportin tremujor, paraqitje lidhur me ashensorin e ri, dhe sqarime në emisionin **Radar** në TV Dukagjini.



Subvencionimi i Fëmijëve autik

Përmes mbështetjes financiare mujore për lehtësimin e barrës ekonomike të familjeve. Mbështetje financiare për familjet e dy qytetarëve të aksidentuar në Itali. Shpërndarja e dhuratave për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përmbledhje

Gjastëmuji i parë i vitit 2026 shënon rezultate të rëndësishme në të gjitha fushat e veprimtarisë së Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Treguesit kryesorë konfirmojnë intensitetin e punës, mbulimin e gjerë të nevojave sociale dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara për komunitetin e Mitrovicës së Jugut.

7743

Shërbime Totale

4662

Raste të Reja

1001

Raste Recidive

Shërbime të ofruara gjatë periudhës janar-qershor 2026 nga Qendra për punë sociale

Raste të reja të regjistruara dhe të menaxhuara gjatë periudhës janar-qershor

Raste të raportuara sërish, me monitorim të vijueshëm

120

Konsulta Psikologjike

115

Aktivitete

1420

Familje Përfutuese të asistencës

sociale

Sesione individuale dhe grupe të mbështetjes psikologjike

Brenda gjastëmuji të parë

7.31% apo në numër total 112 familje më pak

se në dhjetorin e vitit 2025

Puna Kryesore e Drejtorisë

Gjatë gjashtëmujorit janar-qershor 2026, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka realizuar një sërë arritjesh konkrete në fushat e mbështetjes financiare, ushqimore, sociale dhe të partneritetit institucional. Të gjitha aktivitetet janë zbatuar sipas planit vjetor të punës dhe agjendës sociale të drejtorit.

Mbështetja Financiare për pagesën e qirasë në vlerë totale 9,938.68 €.

Mbështetja financiare për përfundimin kohorë Janar – Qershor 2026 në pagesën e qirasë për 13 familje me shumë totale 9,938.68 €.

1687 Pako Ushqimore

Kemi shpërndarë 1687 pako ushqimore, pako me mish, për familjet me asistencë sociale dhe të gjitha kategoritë që i kemi në trajtim si Drejtori.

Shtëpia e Sigurt (e përfunduar)

Përfundimi i projektit dhe funksionalizimi i mekanizmit për mbrojtjen e viktimave të dhunës
Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026 pritet të realizohet hapja dhe funksionalizimi.

244 Kupona Ushqimor

244 kërkesa të aprovuara – pozitive - kupona ushqimor dhe higjienik për qytetaret nga Drejtoria e Mirëqenies

Marrëveshja trevjeçare me Këshillin e Bashkësisë Islame (KBI) në Mitrovicë

Nga Janari deri në Qershor 2026 është 137.510€, përfshirë edhe pagesën retorative të borxhit të mbetur nga muaji Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2025 është 39.880.00€, totali i mbulimit të ceremonive të varrimit për qytetaret e Mitrovicës është 158.460.00€.

2 MILIONË EURO PËR BANIM SOCIAL

Një projekt madhor për banimin social po bëhet realitet në Mitrovicën e Jugut. Me investim prej 2 milionë eurosh, në bashkëpunim me MMPH-në dhe Drejtorinë e Urbanizimit, do të ndërtohen blloqe të reja të banimit social në lokacionin "Kampi i Luajve".

Sektori për Mirëqenie Sociale dhe Strehim

Sektori për Mirëqenie Sociale dhe Strehim përbën shtyllën kryesore operative të Drejtorisë. Gjatë periudhës raportuese, ky sektor ka menaxhuar volumin më të lartë të rasteve dhe ka siguruar shpërndarjen e të gjitha formave të mbështetjes materiale dhe sociale për qytetarët e komunës.

1,100 familje të mbështetura

Ofrimi i mbështetjes sociale dhe humanitare për mbi 1,100 familje në nevojë, përmes pakove ushqimore, ndihmave higjienike dhe mbështetjes financiare, në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Ndihma Ekonomike për Kategoritë Specifike

179 pako ushqimore dhe higjienike

Shpërndarja e 179 pakove ushqimore dhe higjienike, të financuara nga buxheti i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, në vlerë prej 7,858.10 €.

Mbështetje financiare emergjente

Mbështetje financiare emergjente për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike, ujit, lëndëve ngrohëse, etj për familje në gjendje të rëndë sociale, përmes bashkëpunimit me donatorët dhe aktivistët lokal.

1. Organizatat e Dala nga Lufta

2. OJQ "Down Syndrome Kosova"

3. OJQ "HANDIKOS"

4. OJQ "Zëri i Prindërve" –

5. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Raba Voca".

6. Viktimat e dhunës me bazë gjinore – Mbështetje financiare për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026.


7. Shoqata e të Shurdhërve.

8. Shoqata "Minatori '89".

9. Shoqata e të Verbërve.

Statistikat e Qendrës për Punë Sociale

Treguesit statistikorë të periudhës janar–qershor 2026 pasqyrojnë vëllimin e lartë të punës dhe mbulimitin e gjerë të nevojave sociale të qytetarëve të Mitrovicës së Jugut. Të dhënat e mëposhtme janë burimor nga sistemet e regjistrimit të drejtorisë.



Interpretimi i të Dhënave

Janë realizuar 625 seanca këshilluese me palët, 1,092 konsultime dhe 1,447 intervenime profesionale, duke siguruar reagim të shpejtë ndaj nevojave sociale, 168 raste për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe 247 fëmijë kanë vazhduar të përfitojnë mbështetje financiare sipas legjislacionit në fuqi. Janë realizuar 176 vizita në familje, janë hartuar 759 raporte për Gjykatën Themelore, duke ofruar ekspertizë profesionale në procedurat gjyqësore.

Shënime Metodologjike

- Të dhënat mbulojnë periudhën 1 janar – 30 qershor 2026
- Regjistrimi bëhet sipas standardeve Evropiane dhe legjislacionit vendor në fuqi
- Çdo rast llogaritet vetëm një herë si i ri
- Të dhënat zyrtare ndahen me Ministrin e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare

Kategoritë e Mbështetura

Drejtoria e Mirëqenies Sociale ofron shërbime për kategoritë e ndryshme vulnerabël të komunitetit, duke siguruar mbulim të plotë dhe trajtim të diferencuar sipas nevojave specifike të çdo grupi.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, janë mbështetur gjashtë kategori kryesore.



Familjet në Nevoj

Familje me vështirësi ekonomike që marrin asistencë sociale, mbështetje ushqimore dhe shërbime sociale të integruara.



Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët në rrezik, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga familje të varfra — me fokus të veçantë tek mbrojtja dhe edukimi.



Të Moshuarit

Persona mbi moshën e pensionimit pa mbështetje familjare adekuate, të cilët marrin kujdes, vizita shtëpiake dhe shërbime të specializuara.



Personat me Aftësi të Kufizuara

PAK që përfitojnë nga shërbime mbështetëse, asistencë financiare, pajisje ndihmëse dhe programe rehabilitimi social.



Viktimat e Dhunës

Viktimat e dhunës dhe dhunës me bazë gjinore, të cilat mbështeten nëpërmjet Shtëpisë së Sigurt dhe shërbimeve psikosociale dhe mbështetje financiare me 250.00 euro gjatë vitit 2026.



Kategoritë e Dala nga Lufta

Invalide të luftës, familjet e dëshmorëve, veteranët, familjet e viktimave civile, dhe familjet e personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës, të mbijetuarat e dhunës seksuale.



Nënat vetushqyese

Mbështetje sociale përmes pakove ushqimore dhe formave të tjera të përkrahjes për familjet njëprindërore në nevojë.



Fëmijët pa përkujdesje prindërore (Jettimët)

Përkrahje me pako ushqimore dhe dhurata të veçanta gjatë festave të fundvitit dhe festave fetare, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe solidaritetit social.



Komunitetet joshumicë

Mbështetje sociale për komunitetet joshumicë përmes pakove ushqimore dhe ofrimit të ndihmave emergjente për familjet në nevojë.



39 Familjet e prekura nga vërshimet

Gjatë muajve dhjetor-janar, si rezultat i vërshimeve, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka ofruar mbështetje për 39 familje të prekura, përmes ndihmave emergjente dhe përkrahjes sociale për tejkalimin e pasojave të shkakutara.

Sektori DIVC

Dëshmor, Invalid, Veteran, Civil.

Sektori për Përkujdesjen ndaj Familjarëve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës, Veteranëve dhe Viktimave Civile (DIVC) përgjegjes veçanërisht për këto detyra: Tretmanin e familjeve të DIVC dhe çështjen e të zhdukurve, Shokatën e Handikos-it, Shokatën e të Verbërve dhe Shokatën e Shurdhmemeceve.

1	2	3	4
25 Aktivitetet përkujuimore Shënimi i Ditës së Çlirimit (12.06.2026) Shënimi i Ditës së Dëshmoreëve (6.06.2026) Organizimi dhe koordinimi i mbi 25 aktiviteteve përkujuimore, përfshirë homazhe, akademi përkujuimore dhe manifestime kushtuar dëshmoreëve, martirëve, veteranëve dhe viktimave civile të luftës.	Dita e Personave të zhdukur me Dhunë në Mitrovicë (15 prill) Organizimi i aktiviteteve institucionale për Diën e Personave të Zhdukur me Dhunë (15 prill 2026), përfshirë instalacionin simbolik me 104 karriqe të zbrazëta dhe 104 lule, ecjen përkujuimore të nxënësve dhe përkujuimin e Eksodit të vitit 1999 dhe Masakrës së Lagjes së Boshnjakëve.	Dita Kombëtare për Personat e Zhdukur me Dhunë (27 prill) Mbështetja logjistike për shënimin e Ditës Kombëtare të Personave të Zhdukur (27 prill 2026), përmes sigurimit të transportit për familjarët dhe pjesëmarrësit në aktivitetet qendrore.	Aktivitetet Përkujuimor Organizimi i aktivitetit përkujuimor me rastin e 25-vjetorit të rënies së dëshmorit Gazmend Brahimi, me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Komunës, deputetëve, familjarëve dhe qytetarëve.
5	6		
Akademi Përkujuimore Organizimi i akademive përkujuimore për Latif Berishën, Aglin Hajrizin, demonstratat e vitit 1981.	Bashkëpunimi institucional me kategoritë e dala nga lufta Mbështetje me dirijtet për familjet e luftës – përmes ofrimit të ndihmave humanitare dhe mbështetjes emergjente për kategoritë e dala nga lufta, me fokus te familjet në nevojë dhe ruajtjen e mirëqenies së tyre sociale.		

Projektet e Realizuara

Gjatë gjashtëmujorit janar–qershor 2026, Drejtoria ka finalizuar ose ka avancuar ndjeshëm disa projekte të rëndësishme të infrastrukturës sociale dhe politikave komunale. Secili projekt ka sjellë rezultate konkrete dhe të matshme për komunitetin.



Shtëpia e Sigurt

Objekti i Shtëpisë së Sigurt për viktimat e dhunës në familje është konsoliduar plotësisht gjatë kësaj periudhe.



Raporti i Gjendjes Sociale të Komunës

Raporti Social i Komunës për periudhën maj 2026 është finalizuar dhe i është prezentuar Kuvendit Komunal të Mitrovicës në seancën e qershorit, duke pasqyruar gjendjen reale sociale të komunës dhe prioritetet e identifikuara.



Planet Lokale

1. Finalizimi i Planit Lokal të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkall
2. Inicimi për Planin Lokal të Veprimit për Shërbimeve Sociale dhe Familjare
3. Themelimi i grupit punues për Planin Lokal të Riintegritimit

Projektet në Zhvillim

Drejtorja ka në zhvillim aktiv disa projekte strategjike të infrastrukturës sociale, të cilat janë në faza të ndryshme të procesit të planifikimit, projektimit dhe zbatimit. Realizimi i këtyre projekteve do të transformojë ndjeshëm kapacitetin e shërbimeve sociale komunale.

Rezidencia për të Moshuarit

Ndërtimi i një rezidence sociale të dedikuar për të moshuarit pa mbështetje familjare, me kapacitet të mjaftueshëm dhe shërbime profesionale të kujdesit.

Banimi Social

Zgjerimi i kapacitetit të banimit social komunal, me ndërtim të njësisve të reja të përshtatshme për familjet prioritare.

Renovimi i Qendres së të Shurdhve

Rinovimi i plotë dhe modernizimi i Qendres Komunale për personat me dëmtim dëgjimor, duke siguruar kushte moderne dhe të denja.

1

2

3

4

5

Shtëpia për Mbrojtjen e Fëmijëve

Hapja e një qendre rezidenciale të specializuar për fëmijët në rrezik dhe fëmijët e braktisur, si alternativë e

Qendra për Autizëm

Themelimi i një qendre të specializuar për fëmijët me çrregullim të spektrit autik.

institucionalizimit.

Prioritetet Strategjike

Bazuar në vlerësimet e nevojave dhe analizën e situatës sociale të komunës, Drejtoria ka përcaktuar prioritetet strategjike të punës për periudhën e ardhshme. Renditja e mëposhtme pasqyron saktësisht hierarkinë e prioriteteve sipas dokumentit zyrtar të drejtorisë.

01		02	
Shtëpia e Sigurt		Rezidenca për të Moshuarit	
Konsolidimi dhe zgjerimi i kapaciteteit të Shtëpisë së Sigurt për viktimat e dhunës në familje		Finalizimi i projektit dhe fillimi i ndërtimit të rezidencës sociale për të moshuarit	
03		04	
Shtëpia për Mbrojtjen e Fëmijëve		Renovimi i Qendrës së të Shurdhve	
Avancimi i procesit të licencimit dhe hapjes së qendrës rezidenciale për fëmijët		Fillimi i punimeve të renovimit dhe modernizimit të qendrës ekzistuese	
05		06	
Qendra për Autizëm		Kuzhina Popullore	
Hartimi i studimit të fizibilitetit dhe sigurimi i financimit për qendrën e specializuar		Krijimi i kuzhinës popullore komunale si shërbim ushqimor për grupet më vulnerabel	
07		08	
Banimi Social		Programi për Fuqizim Ekonomik	
Zgjerimi i kapacitetit të banimit social komunal dhe adresimi i listës së pritjes		Zbatimi i programit gjithëpërfshirës për fuqizimin ekonomik të familjeve në asistencë sociale	

Objektivat Afatmesme

Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka hartuar objektivat afatmesme të punës si pjesë integrale e strategjisë sociale komunale. Këto objektiva janë të orientuara nga rezultate konkrete, të matshme dhe të lidhura me prioritetet kombëtare të zhvillimit social.

Fuqizimi i Sistemit të Shërbimeve

- Rritja e numrit të punëtorëve socialë sipas normave të BE-së
- Dixhitalizimi i plotë i sistemit të menaxhimit të rasteve
- Akreditimi i shërbimeve sipas standardeve kombëtare
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit profesional

Zhvillimi i Infrastrukturës Sociale

- Ndërtimi i rezidencës për të moshuarit
- Hapja e qendrës rezidenciale për fëmijët
- Themelimi i Qendrës për Autizëm
- Renovimi i infrastrukturës ekzistuese

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

- Tërheqja e fondeve të BE-së për projekte sociale
- Partneritete me organizata ndërkombëtare të specializuara
- Shkëmbime të praktikave me komuna partnere

Fuqizimi Ekonomik dhe Integrimi Social

- Ujja e numrit të familjeve në asistencë sociale me 15% brenda dy vjetësh
- Zbatimi i programeve të punësimit për përfituesit
- Rritja e numrit të parcelave bujqësore të ndara
- Trajnime profesionale të targetuara sipas tregut

Mbrojtja e Grupeve Vulnerabël

- Zgjerimi i shërbimeve për PAK në të gjitha fshatrat e komunës
- Forcimi i mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve
- Shtirja e shërbimeve të kujdesit shtëpiak për të moshuarit
- Intensifikimi i shërbimeve antidhunë


Transparencia dhe Llogaridhënia

- Raportim periodik publik i rezultateve
- Konsultime me qytetarët dhe grupet e interesit
- Audit i pavarur i shërbimeve sociale

Vizioni Social

Nga asistenca pasive drejt fuqizimit, integritit dhe jetesës së pavarur

Vizioni i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale bazohet në transformimin çlësor të sistemit social — nga një sistem që ofron mbështetje pasive drejt një sistemi që fuqizon, integron dhe promovon pavarësinë e qëndrueshme të qytetarëve.



Ky model transformues është i bazuar në praktikat më të mira europiane të punës sociale dhe është i adaptuar ndaj kontekstit specifik të komunës së Mitrovicës së Jugut. Ai kërkon investim të qëndrueshëm, bashkëpunim ndërsektorial dhe angazhim afatgjatë institucional nga të gjithë aktorët relevantë të komunitetit dhe politikës publike.

Dinjteti

Çdo qytetar ka të drejtë të jetojë me dinjitet, pavarësisht situatës ekonomike

Pavarësia

Synimi final është pavarësia ekonomike dhe sociale, jo varësia afatgjatë nga sistemi

Gjithëpërfshirja

Çdo anëtar i komunitetit i takon plotësisht shoqërisë, pa përjashtim e stigmatizim

Konkluzionet

Raporti gjashtëmujor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për periudhën janar–qershor 2026 dëshmon qartë intensitetin e punës dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara. 7743 shërbime të realizuara, 4662 raste të reja të trajtuara, 1420 familje përfituese dhe 120 konsulta psikologjike janë tregues konkretë të angazhimit institucional ndaj qytetarëve të komunës.

Kapaciteti Institucional

Drejtoria ka demonstruar kapacitet të lartë institucional për menaxhimin e numrit të madh të rasteve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore, duke ruajtur standardet profesionale gjatë gjithë periudhës.

Prioritizimi Korrekt

Fokusi i qëndrueshëm tek fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe viktimat e dhunës pasqyrojnë priorizim korrekt të grupeve me nevojat më urgjente sociale.

Infrastruktura Sociale

Progresi i bërë në projektet e infrastrukturës sociale Shtëpia e Sigurt, projekti i Rezidencës për të Moshuarit, Qendra për Autizëm konfirmojnë drejtimin strategjik afatgjatë.

Transformimi i Modelit

Orientimi drejt fuqizimit ekonomik dhe reduktimit gradual të asistencës pasive tregon maturim institucional dhe vizion social të qëndrueshëm, në përputhje me standardet europiane.


Gjashtëmujori i parë i vitit 2026 është ndërtuar mbi bazën e angazhimit, transparencës dhe profesionalizmit. Drejtoria e Mirëqenies Sociale mbetet e vendosur të vijojë rrugën e nisur, një rrugë që çon drejt një komunë ku çdo qytetar ka dinjitet, mundësi dhe mbështetje në punën institucionale.

RAPORTET ANALITIKE DHE STATISTIKORE TË ÇDO SEKTORI TË MIRËQENIES SOCIALE

1. Sektori i Mirëqenies Sociale dhe Strehimit

2. Sektori DIVC

3. Qendra për Punë Sociale





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore

Raporti i punës për Periudhën Janar – Qershor 2026

1) Sektori për Mirëqenie Sociale dhe Strehim

Sektori për Mirëqenie Sociale dhe Strehim, aktivitetet e punës i mbështet në dispozitat ligjore të Republikës së Kosovës të cilat e rregullojnë lëminë e Mirëqenies Sociale dhe të strehimit. Drejtoria për Mirëqenie Sociale duke u mbështetur në të dhënat në dispozicion dhe gjendjen reale në terren, konsiderojnë se numri i kërkesave të shumta për ndihma ushqimore – higjienike, strehim, pagesën e qirave të banimit, është i arsyeshëm.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2026, kemi pranuar 289 kërkesa të ndryshme prej të cilave 244 janë aprovuar – pozitive, 42 janë refuzuar – negative, 3 janë mbetur në proces. Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2026, (përveç kërkesave nga vitet paraprake), nuk ka pasur kërkesa të paraqitura për banim social nga familjet që plotësojnë kushtet e as kërkesa për strehim momental.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2026, janë realizuar projekte dhe veprime punuese si në vijim:

Mbështetja financiare për periudhën kohore Janar – Qershor 2026 në pagesën e qirasë për 13 familje me shumë totale 9,938.68 €. Pas aplikimit të kërkesës së këtyre familjeve në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, është bërë verifikimi i dokumentacionit si dhe janë realizuar vizitat familjeve në fjalë.

Më 27.03.2026, është propozuar dhe miratuar ne Asamblen Komunale të Mitrovicës së Jugut vazhdimi i Marrëveshjes tri vjeqare për Kryerjen e Shërbimeve dhe Ceremonive Fetare në mes të BIK-ut dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Mitrovicës së Jugut, me numër të Protokollit 01.352/05-0028681/26 të datës 18.05.2026 gjatë periudhës Janar – Qershor 2026 në shumë totale 97.640 €.

Me date 16.02.2026 gjatë kësaj periudhe kohore Janar – Qershor 2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë e Drejtorisë Sociale kanë qenë të angazhuar në vizitë në Bashkësinë Islame në Mitrovicë me z. Ekrem Avdiu, deklaruar se do të kemi bashkëpunim shumë të mirë me Drejtorinë për Mirëqenie Sociale dhe me popullatën e Mitrovicës në përgjithësi. z. Ramadan Beshiri deklaroi se Brenda mundësive ne do të bëjmë një projekt/koncept strategjik social për Mitrovicën. Po ashtu Drejtori i dorëzoi me shkrim një projekt strategjik për t'na ndihmuar në gjetjen e dy familjeve strehuese për fëmijët e braktisur. Bashkësisia Islame në Mitrovicë përmes OJQ-së „Beregeti” i ka ndihmuar 500 familje me pako ushqimore dhe higjienike.

Gjatë periudhës kohore Janar – Mars 2026, OJQ Islamic Relief Kosova ka ndihmuar 10 familje me nga 5 m. dru për ngrohje.

Gjatë muajit janar në kohën e vërsimeve janë ndihmuar 39 familjetë prekura nga vërshimet me pako ushqimore dhe higjienike nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

Ne periudhën kohore Janar – Qershor 2026, kemi qenë të angazhuar në vizitat që kryen Komisioni tek familjet të cilat aplikojnë për pagesë të qirasë, dhe identifikimin e rasteve, të cilat jetojnë në kushte të vështira jetese.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë Sociale kanë qenë të angazhuar në vizita në Fshatin Frashër tek objekti Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijëve, sepse ende ka mbetur pa përfunduar projekti nga UNMIK-u. Nuk i kanë kryer rrethojen e objektit sipas marveshjes, inventarin e mbrendëshum dhe kabina për roje.

Me 28.01.2026 ka pas disa takime zyrtare që ka pasur Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë të UNMIK-ut, znj. Arsie Begiri Gjyshtinca dhe znj. Alketa Shala ku mbetët të të sigurohen mjete për përfundimin e punëve të mbetura në Shtëpinë e Sigurt në Frashër, Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë e Drejtorisë Sociale kanë qenë të angazhuar në vizita në terren ku janë kryer rreth 100 vizita në institucione qeveritare dhe jo qeveritare si dhe në familje raste të ndryshme sociale.

Me date 22.01.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë e Drejtorisë Sociale kanë pasur takim pune në Qendrën për Punë Sociale ku qëllimi i takimit ka qenë

problemet në punë ne Shërbimet Sociale dhe Skemën Sociale. Problemi kryesor në Shërbimet Social është Familjet Strehuese për Fëmijët e Braktisur, parkinku i veturave dhe mungesa e zyrtarëve për vendet e lira të punës (Stafin), dhe një vetur me pas në Shërbim 24 orë.

Me date 22.01.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë e Drejtorisë Sociale kanë vizituar Stacionin Policor në lagjen e Qatari Charity në Frashër, ku temë diskutimi ka qenë gjendja e familjeve dhe sjelljet e tyre, e vegëanarisht familja e z. Bashkim Ceroviku, sepse kësaj familje qe një kohë të gjatë ju është ndërprerë rryma përshkak të borxheve.

Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me aktivista të Lagjes ILIRIDË kanë kryer aktivitet humanitar duke grumbulluar mjete financiare dhe duke i'a shyer borxhin e rrymës z. Bashkim Cerovikut në shumë prej 920 € Veteran i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Me date 22.01.2026 gjatë kësaj periudhe kohore Janar – Qershor 2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë e Drejtorisë Sociale kanë pasur takim pune ne Shokatën e Pensionistëve të Mitrovicës, ku problem i tyre është përparja dhe janë ndarë ne dy grupe ku secili grup akuzo tjetrin.

Me date 03.03.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me përfaqësuesit e OJQ-së Zëri i Prindërve me znj. Xhyla Haziri e cila na njoftoi rreth punës dhe problemeve qe përballlet OJQ-ja „Zëri i Prindërve“ për personat e të pagjetur. Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI i konfirmoj se ne kuadër të mundësive të DMS-së do ta ndihmoj ne punët qe kryen OJQ-ja Zëri i Prindërve, dhe momentalisht ti përzgjedhin 10 deri 15 familje ne kushte ma të randa ekonomike sociale për ti ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike.

Me date 03.02.2026 gjatë kësaj periudhe kohore Janar – Mars 2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me zyrtarët policis z. Enver Makiqi dhe z. Emir Kalludra ku u bisedua rreth rastit të Mimoza Mehaj për problemet qe po i sjell tek banorët e ndërtesës ish Kampi i Luajve në Shipol.

Me date 04.02.2026 gjatë kësaj periudhe kohore Janar – Mars 2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me OJQ-në „Raba Voca“ me

znj. Fridane Hyseniku njoftoj se momentalisht janë të strehuara 13 raste të dhunës gjatë muajit janar dhe Shkurt të këtij viti ku në mbështetje kemi QPS-në Policin dhe Emergjencën. Problemi kryesor është objekti me qera dhe borxhet që kemi për shpenzime të rrymës ku dy vitet e fundit komuna e Skenderajit dhe e Vushtrisë nuk i kanë kryer obligimet e marveshjes.

Me date 04.02.2026 gjatë kësaj periudhe kohore Janar – Qershor 2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me Drejtorin e Shëndetit Mirëqenie Sociale z. Azem Haliti i cili njoftoi se Qendra e Shëndetit Mendor ne Iliridë ka hapësir për 17 persona me ushqim dhe gjitha kushtet tjera, kjo Qendër nuk merret me raste të Shëndetit Mendor të rrezikshme, por për shërbime emergjente duhet përmes policies dhe Spitalit të Prishtinës, kushti i parë për trajtimin e tyre është mungesa e Spitalit Psikiatrik ne Mitrovicë.

Me date 05.02.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me Drejtoreshën e **SOS Fshatit** në Prishtinë znj. Ora Bityqi k una njoftoi për punën që kryhet në SOS Fshatin me fëmijët e strehuar deri të pavarësimi i tyre, drejtoresha Ora Bityqi deklaroi se ne kuadër të mundësive do ta ndihmoj Komunën e Mitrovicës për familjet strehuse.

Me date 09.02.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim pune me Drejtoreshën e policies së Kosovës në Mitrovicë znj. Aferdita Mikullovcit ku është dakorduar që së bashku me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, Drejtorin e Arsimit dhe Drejtorin e Shëndetësisë, Kryqin e Kug të punojm ne parandalimine e fëmijëve me sjellje asociate, bullizimet, keqpërdorimin e rrjetëve sociale etj. Drejtori z. Ramadan BESHIRI kërkoi që Drejtoresha znj. Aferdita Mikullovcit gjatë takimeve me delegacione nderkombëtare, si dhe Organizata Qeveritare dhe Jo Qeveritare të kërkon mbështetje për ndërtimin e disa objekteve siq është: Objekti për strehimin dhe trajtimin e personave që merren me drog, objekte për trajtimin e fëmijëve dhe mundësi për ndonjë investim për punësim për ti punësuar familjar të rasteve Sociale .

Me datë 11.02.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me përfaqësuesit e OJQ-së Iniciativa Zgjatma Doren ku gjatë takimit u dakorduan që përmes tyre të ndihmohen 50 familje raste sociale me pako ushqimore dhe higjienike nga OJQ Mamusha prizeren.

Me date 18.02.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë kanë pasur Takim me zv. Shëfën e UNMIK-ut znj. Insirovic për finalizimin e "Shtëpisë së Sigurtë" në Frashër dhe nisjen e rrethojave.

Me date 23.02.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë kanë pasur takim me përfaqësuesit e OJQ-së DOWN Syndrom Kosova z. Xhenis Begiri ku gjatë takimit u njoftuan me problemet që ka kjo OJQ. Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI i konfirmoj se në kuadër të mundësive të DMS-së do ta ndihmoi në punët që kryejn kjo OJQ dhe momentalisht ti përzgjedhin 10 familje në kushte ma të randa ekonomike sociale për ti ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike.

Me date 24.02.2026 gjatë kësaj periudhe kohore Janar – Mars 2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë kanë pasur takim pune me Drejtorin e Shkolës Qendra Burimore Nënë Tëreza" z. Skender Avdiu i cili njoftoi rreth punës dhe problemeve që përballlet kjo Shkolë.

Me date 03.03.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë kanë pasur takim me përfaqësuesit e OJQ-së të Vërbërit ku u njoftuan rreth punës dhe problemeve që përballlet kjo OJQ . Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI i konfirmoj në kuadër të mundësive të DMS-së do ta ndihmoi në punët që kryejn kjo OJQ dhe momentalisht ti përzgjedhin 10 familje në kushte ma të randa ekonomike sociale për ti ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike.

Me date 03.03.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë kanë pasur takim me përfaqësuesit e Organizatës të Veteranëve të Luftës së UÇK-së z. Shyqiri Peci dhe Sabit Shëremeti të cilët e njoftuan rreth punës dhe problemeve që përballlet kjo OJQ. Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI i konfirmoj se në kuadër të mundësive të DMS-së do ta ndihmoi në punët që kryejn Organizata e Veteranët të Luftës së UÇK-së.

Me date 03.03.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyratë kanë pasur takim me përfaqësuesit e OJQ-së Familjet e Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së znj. Sadet Agolli e cila na njoftoi rreth punës dhe problemeve që përballlet OJQ-së Familjet e Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së. Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI i konfirmoj se

në kuadër të mundësive të DMS-së do ta ndihmoi ne punët që kryejn OJQ-ja Familjet e Dëshmoreve të Luftës së UÇK-së.

Me date 03.03.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me përfaqësuesit e Organizata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së z. Naser Islami i cili njoftuan rreth punës dhe problemeve që përballët Organizata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së. Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI i konfirmoj se ne kuadër të mundësive të DMS-së do ta ndihmoi Organizata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së.

Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë i njoftoi tri Shogatat e dalura nga Lufta e UÇK-së ti përzgjedhin 60 familje ne kushte ma të randa ekonomike sociale për ti ndihmuar me pako ushqimore dhe higjienike.

Me date 04.03.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë dhe Drejtori i Drejtorisë për Arsime z. Shetki BEGU kanë vizituar Familjen e z. Isuf Uka dhe Shkollën Fillore „Jashar Begu” në fshatin Villahi, ku takuan Drejtoreshën e Shkollës znj. Elmaze Hasani e cila njoftoj rreth problemit të fëmijëve të z. Isuf Uka dhe gjendjen e tyre ekonomike sociale dhe shëndetësore.

Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë e ndihmoan këtë familje me dy pako ushqimore e higjienike, dhe po ashtu z. Ramadan BESHIRI i dorëzoi drejtoreshës së Shkollës znj. Elmaze Hasni 80 € para për ta ndihmuar dhe menaxhuar mjete të kësaj familje për nevojat e tyre.

Me date 12.03.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me Drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe zyrtarë të Drejtorisë së Urbanizmit rreth problemeve të banimit social, banesave të vjetra ne Tunel të Parë dhe programit Qeveritar të Ministris të Planifikimit Hapësinor për renovimin e tyre.

Me date 17.03.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrtarë kanë pasur takim me kordinatorin e projekteve për persona me Afësi të Kufizuar z. Petrit BLACA OJQ-ja PEDA, dhe Grupin Punues për Planifikim dhe zbatim të projekteve për përsërit me Afësi të Kufizuar. Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI i konfirmoj se ne kuadër të mundësive do ta ketë përkatëse nga DMS-ja.

Me date 08.04.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrarë Drejtorisë Sociale kanë pasur takim pune në Qendrën për Punë Sociale ku qëllimi i takimit ka qenë problemet e punës në Shërbimet Sociale dhe Skemën Sociale. Problemi kryesor në Shërbimet Social është Familjet Strehuese për Fëmijët e Braktisur, parkinku i veturave dhe mungesa e zyrarëve për vendet e lira të punës (Staffin), dhe një vetur me pas në Shërbim 24.

Me date 08.04.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrarë kanë pasur takim pune me Drejtoreshën e policies së Kosovës në Mitrovicë z. Ahmet Xhoshja ku është dakorduar që së bashku me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, Drejtorin e Arsimit dhe Drejtorin e Shëndetësisë, Kryqin e Kuq të punojm në parandalimin e fëmijëve me sjellje asociatale, bullizimet, keqpërdorimin e rrjetëve sociale etj; po ashtu është diskutuar edhe për të sëmuarit psikik që në kuadër të mundësive të krijohet të paktën dy dhoma për trajtimin e tyre.

Me date 08.04.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrarë kanë pasur takim me përfaqësuesit e OJQ-së Zëri i Prindërve me znj. Xhyla Haziri e cila na njoftoi rreth punës dhe problemeve që përballen OJQ-ja „Zëri i Prindërve” na njoftoj se janë 104 persona të të pagjetur. Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI i konfirmoj se në kuadër të mundësive të DMS-së do ta ndihmoi në punët që kryen OJQ-ja Zëri i Prindërve

Me date 08.04.2026 Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale z. Ramadan BESHIRI me zyrarë kanë pasur takim me përfaqësuesit e OJQ-së Se Bashku me znj. Besa Mahmuti dhe Bukurije Brezhnica të cilat na njoftuan rreth punës dhe problemeve që përballen OJQ-ja „Së Bashku” rreth problemeve të financimit .

